



Peshqirët e lëkurës

Kujdesi për lëkurën fillon me një kanavacë të freskët, dhe ky set peshqirësh fytyre ultra të butë prej 100% pambuku është zgjidhja juaj e preferuar për pastrim dhe përkëdhelje të butë dhe efektive të lëkurës pas çdo hapi të ritualit tuaj të kujdesit për lëkurën.

Pavarësisht nëse jeni duke fshirë ditën ose duke përmirësuar rutinën tuaj të kujdesit të lëkurës, ky grup peshqirësh për fytyrën është një luks i thjeshtë por thelbësor.

Peshqirët e fytyrës (pako me 2):

- Është luksozisht i butë dhe thithës
- Është ideal për pastrim, avullim dhe tharje të butë
- Mund të lahet në lavatriçe, mund të ripërdoret dhe është gati për përdorim të përditshëm
- Ka markë elegante – E qëndisur me një logo delikate të Herbalife për një prekje të rafinuar

Mënyrat e përdorimit të peshqirëve për lëkurën tuaj:

1. **Pastrimi.** Lagni fytyrën dhe aplikoni pastruesin që preferoni. Lagni pak peshqirin e fytyrës dhe masazhoni fytyrën me lëvizje të buta rrethore për ta eksfoliuar dhe për të larguar yndyrën, papastërtitë dhe mbetjet e tjera.
2. **Tharja.** Me peshqirin e butë dhe përtithës për lëkurë, thani fytyrën butësisht pas dushit ose pas pastrimit. Është e rëndësishme të përdorni peshqir të ndarë për fytyrën dhe trupin, për të ruajtur higjienën dhe për të parandaluar bartjen e baktereve.

3. **Avullimi.** Mund të përdorni peshqirin e fytyrës për të bërë një trajtim me avull në kushte shtëpie, për një përvojë si në spa. Lagni peshqirin me ujë të ngrohtë, shtrydheni për të larguar ujin e tepërt dhe vendoseni mbi fytyrë. Mbani peshqirin mbi fytyrë për 5–10 minuta. MOS përdorni ujë të valuar apo shumë të nxehtë, sepse mund të shkaktojë djegie ose irritim të lëkurës.

MIRËMBAJTJA/RUAJTJA

1. **Larja.** Lani peshqirët e fytyrës pas çdo përdorimi, me ujë të nxehtë dhe detergjent të butë pa aromë. Mos përdorni zbutës rrobash pasi lë mbetje në peshqir që mund të irritojnë lëkurën gjatë përdorimit.
2. **Tharja.** Tharja është po aq e rëndësishme sa edhe larja. Është e domosdoshme ta varni peshqirin në një vend të ajrosur, që të thahet plotësisht dhe të shmangët zhvillimi i baktereve që shkaktojnë akne. Si alternativë, mund të përdorni tharëse rrobash për të eliminuar të gjitha bakteret.
3. **Ruajtja.** Mbani peshqirët gjithmonë në një vend të thatë dhe mos i palosni nëse nuk janë tharë mirë, për të parandaluar përhapjen e baktereve.

PYETJE TË SHPESHTA (FAQ)

FAQ 1: A duhet të përdor peshqirë të ndarë për fytyrën dhe trupin?

Patjetër! Përdorimi i peshqirëve të ndarë për fytyrën dhe trupin parandalon bartjen e baktereve nga pjesë të trupit në fytyrë, duke ulur rrezikun për acarime apo probleme të tjera të lëkurës.

FAQ 2: A mund ta përdor këtë peshqir për të hequr grimin?

Edhe pse mund ta përdorni për të hequr grimin, vetëm peshqiri nuk është gjithmonë efektiv dhe mund të jetë irritues për lëkurën. Këshillohet që fillimisht të përdorni një pastrues grimi për të larguar sa më shumë produkt, dhe pastaj të përdorni peshqirin për mbetjet.

FAQ 3: A mund ta përdor këtë peshqir në vend të brushës për pastrim?

Edhe pse nuk e ofron efektin masazhues si brusha, peshqiri mund të jetë alternativë e mirë për eksfolim dhe pastrim të lëkurës.

FAQ 4: Çfarë detergjenti duhet të përdor për larjen e peshqirëve të fytyrës?

Detergjenti hipoalergjik është zgjedhja më e mirë, por edhe një detergjent i butë pa aromë është më se i mjaftueshëm.

FAQ 5: Sa shpesh duhet t'i ndërroj peshqirët e fytyrës?

Zakonisht këshillohet t'i ndërroni peshqirët çdo 3–6 muaj, ose më shpesh varësisht nga dëmtimi apo përdorimi. Për ta zgjatur jetëgjatësinë e peshqirëve, sigurohuni që t'i lani dhe t'i thani gjithmonë siç duhet

Emri: Set peshqirësh për fytyrën

Kodi i grupit: PO/82891-5

Materiali: 100% Pambuk

Importuar nga:

ASL Netherlands B.V. Kingsfordweg 151, 1043 GR, Amsterdam, The Netherlands

Regjistrimi i kompanisë 67368468

Nr. i TVSH-së. NL856951997B01

Prodhuar në Kinë

Prodhuar për: Herbalife International Luxembourg S.à R.L. 16, Avenue de la Gare L-1610 Luxembourg

www.herbalife.com

GPSR_support@link-worldwide.com